

VENDIM
Nr. 562, datë 29.9.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 335, DATË 6.6.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN, TË PROCEDURËS DHE KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit termi “aplikim” zëvendësohet me “kërkesë”, ndërsa termi “aplikues” zëvendësohet me “kërkues”.

2. Shkronja “ç”, e pikës 3, të kreut II, riformulohet, si më poshtë vijon:

“ç) Një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)”.

3. Shkronja “ç”, e pikës 5.4, të kreut II, riformulohet, si më poshtë vijon:

“ç) Modifikimin e etiketës së PMB-së, sipas përcaktimeve të pikës 4, të kreut VII”.

4. Pika 5.7, e kreut II, pika 7, e kreut IV, si dhe pika 1, e kreut V, shfuqizohen.

5. Pika 1, e kreut IV, riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Kërkesa për regjistrimin e PMB-së kryhet në sistemin *on-line* dhe përmban:

a) të dhënat teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-së, në gjuhën shqipe ose angleze, të miratuar me urdhër të ministrit;

b) të dhënat që provojnë se PMB-ja është e regjistruar nga kërkuesi në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose kërkuesi ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të regjistrimit nga subjekti, që e ka regjistruar në një nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilat janë: certifikata e regjistrimit ose vërtetimi i lëshuar nga institucionet zyrtare kompetente, numri i regjistrimit, sipas adresës elektronike të shtetit që e ka regjistruar PMB-në, dhe etiketa përkatëse. Etiketa të jetë e përkthyer edhe në gjuhën shqipe;

c) dokumentacionin për të dhënat e sigurisë (MSDS), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”. MSDS-ja të jetë e përkthyer edhe në gjuhën shqipe.”.

6. Pika 2, e kreut V, riformulohet, si më poshtë vijon:

“2. Brenda 20 (njëzet) ditëve nga kërkesa, sekretari i komisionit shqyrton dokumentacionin sipas pikës 1, të kreut IV, dhe, nëse është në rregull, menjëherë pas pranimit, dërgon me *e-mail* zyrtar tek ISUV-i, dokumentacionin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut IV. Ndërsa dokumentacionin, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij kreu, si dhe vlerësimin e dërguar nga ISUV-i, ua dërgon anëtarëve të komisionit të regjistrimit të PMB-ve, kur bën njoftimin për mbledhjen e radhës së komisionit.”.

7. Pika 3, e kreut V, riformulohet, si më poshtë vijon:

“3. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) kryen vlerësimin e dokumentacionit dhe e dërgon mendimin me shkrim tek SPMB-ja brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e marrjes.”.

8. Në pikën 4, të kreut VII, fjalë me përmbajtjen “Në të gjitha rastet e përcaktuara në këtë pikë, aplikanti duhet të paraqesë kërkesë në gjuhën shqipe.” riformulohet, si më poshtë vijon:

“Në të gjitha rastet e përcaktuara në këtë pikë, kërkuesi kryen kërkesën në sistemin *on-line*, shoqëruar me dokumentacionin provues.”.

9. Pika 6.2, e kreut VII, riformulohet, si më poshtë vijon:

“6.2 Pas çregjistrimit, nëse PMB-ja është ende në treg, ajo të përdoret brenda afateve të skadencës së saj, me përjashtim të përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 6, të këtij kreu.”.

10. Pas pikës 6.2, të kreut VII, shtohen pikat 6.3 dhe 6.4, me këtë përmbajtje:

“6.3 Pas çregjistrimit sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 6, nëse PMB-ja është ende në treg, të tregtohet brenda afateve të përcaktuara në urdhrin e ministrit për lëndën vepruese në përmbajtje të PMB-së.

6.4 Pas çregjistrimit sipas përcaktimit të shkronjës “ç”, të pikës 6, nëse PMB-ja është në treg, të hiqet menjëherë nga tregu.”.

11. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama